



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT VJETOR – 2016

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	Raporti vjetor për vitin 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes / ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë vitit 2016, në 6 zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **35,601** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **35,179** kërkesa, janë refuzuar **302** dhe kanë mbetur në procedurë edhe **120** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produktëve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

Gjatë vitit 2016, në Drejtorinë e Kadastrit, nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, Sektorit të kadastrit dhe atij të gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme, prej të cilave:

I. Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 3,997 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar 3,695, janë refuzuar 230 kërkesa, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 72 konkluzione, duke e pezulluar procedurën deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse.;
- 210 kërkesa për historik nga persona fizikë, institucione, prej të cilave janë miratuar të gjitha;
- 3,174 shkresa / kërkesa nga institucionet e ndryshme, prej të cilave janë miratuar 3,164 dhe në procedurë kanë ngelur edhe 10 kërkesa;
- 412 kërkesa për përmirësime në RDPP, prej të cilave janë miratuar 327, janë refuzuar 51 dhe në procedurë kanë ngelur edhe 34 kërkesa;
- 1,581 kërkesa të tjera për përmirësime, ankesa, plotësime të lëndëve, të cilat janë miratuar në tërësi;
- 84 kërkesa për barra tatimore, janë miratuar në tërësi;
- 726 kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe 522 kërkesa për çregjistrim të hipotekave, nga të cilat janë miratuar të gjitha.

Totali i kërkesave / lëndëve të pranuar dhe të përpunuara në Sektorin e RDPP-së, gjatë vitit 2016 ka qenë 10,706 kërkesa.

II. Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 22,600 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kopje të planit;
- 82 kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë miratuar 79, ndërsa në procedurë kanë mbetur 3 kërkesa;
- 72 kërkesa për bashkim të parcelave, të miratuara të gjitha;
- 670 kërkesa për dhënie të produkteve (koordinatave) kadastrale, të realizuar të gjitha;
- 850 kërkesa për identifikimin e njësisë banesore, nga të cilat janë miratuar 845, ndërsa në procedurë kanë mbetur vetëm 5 kërkesa;
- 109 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar të gjitha.
- 26 kërkesa për ndërrim kulture, nga të cilat janë miratuar 24, në procedurë ka mbetur 1 lëndë dhe 1 lëndë është refuzuar;
- 12 kërkesa për plotësim pagese;
- 274 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë miratuar 259, nga të cilat 5 kërkesa kanë mbetur në procedurë, ndërsa 10 janë refuzuar;
- 200 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, drejtoritë e Komunës së Prishtinës, AKP, KPA, ministritë etj., nga të cilat janë miratuar 200 dhe kanë mbetur në procedurë edhe 3 kërkesa.

Totali i kërkesave / lëndëve të pranuar dhe të përpunuara në sektorin e gjeodezisë gjatë vitit 2016 ka qenë 24,895 kërkesa.

Nga të dhënat e lartshënuara, shihet se Drejtoria e Kadastrit ka implementuar më shumë se 90 përqind të planit, duke i miratuar, refuzuar ose pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa. E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palë/subjektet fizike dhe juridike.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

Aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit, janë:

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej 5 ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së pa luajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkivi Komunal ose Arkivi Ndërkomunal.

Aktivitetet në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë, janë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësisve banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit gjatë vitit 2016	Numri i përgjiths hëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	22,600	22,600	0	0	9,770
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	3,997	3,695	230	72	138,834
Kërkesa për historik - zyrtare, historik për persona fizikë dhe juridikë	210	210	0	0	2,300
Kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	3,174	3,164	10	0	718
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësime lëndë etj.	1,581	1,581	0	0	1,035
Përmirësime në RDPP	412	327	51	34	8,200
Barra tatimore	84	84	0	0	1,260
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	726	726	0	0	74,860
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	522	522	0	0	5,095
Ndarjet – parcelimet, copëtimet	82	79	0	3	4,502
Bashkimi i parcelave	72	72	0	0	2,380
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	670	670	0	0	18,602
Identifikimi i parcelave dhe njësisve banesore	850	845	0	5	17,000
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	109	109	0	0	7,359
Ndërrim i kulturës	26	24	1	1	57,400
Kërkesat me licencë	274	259	10	5	17,553
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	200	200	0	0	289
Totali	35,601	35,179	302	120	367,157

4.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.2. Takimet me palë

1. **Spektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (të martave dhe të enjteve) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palëve. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth 3,895 qytetarë.
2. **Spektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë. Gjatë vitit 2016, kemi pranuar 3,179 palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, kemi takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. Takimet me institucione të tjera

- **Spektori i kadastrit** - Takim me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale, pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'i drejtohen institucioneve të tjera në vend. Takimet bëhen në baza ditore, si dhe çdo të marte dhe të enjte nga ora 10:00 - 12:00 paradite.
- Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyer nga kjo agjenci.

6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

- Gjatë vitit 2016, kemi mbajtur 3 diskutime publike të përgjithshme.

6.1.1. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Në Drejtorinë e Kadastrit kemi pasur disa kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

- **Spektori i kadastrit**
 - Lëndë të pranuar: 10,706
 - Lëndë të miratuara: 10,309
 - Lëndë të refuzuara: 291
 - Lëndë në procedurë: 106
- **Spektori i gjeodezisë**

- Lëndë të pranuar: 24,895
- Lëndë të miratuara: 24,870
- Lëndë të refuzuara: 11
- Lëndë në procedurë: 14

7. Takime të tjera

Kemi pasur edhe takime të tjera me palë, të cilat takime janë bërë me palë të ndryshme nga drejtoria dhe 2 udhëheqëset e sektorit. Kemi pasur gjithsej **7,074** takime për çështje të ndryshme pronësore, nga të cilat takime palët kanë marrë rekomandime dhe sugjerime varësisht nga natyra e problemit.

8. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

Spektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucionet, mosdhënia e përgjigjeve nga ana e tyre në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
4 kërkesa janë në pritje për verifikime në Arkivin Komunal dhe atë Ndërkomunal;
98 kërkesa janë në pritje për verifikime në Gjykatë;
21 kërkesa janë në pritje për verifikim në AKP;
20 kërkesa janë në pritje për verifikime në NPB;
16 kërkesa janë në pritje për verifikime në KPA;
2 kërkesa janë në pritje për verifikime në Drejtorinë e Financave dhe Pronës.

Spektori i gjeodezisë:

- Sfidues është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mos përgjigjet e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin “Cadastral Map” dhe “SITK”, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

9. *REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.*

Spektori i kadastrit:

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj;
- Furnizim me dollapë për arkivim të lëndëve të pezulluara dhe të refuzuara;
- Furnizim me një skaner, i cili do të na ndihmonte në mbarëvajtjen e punës.

Sektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punëtorë sa i përket aplikimit të kornizës së punës;
- Furnizim me një skaner, i cili do të na ndihmonte në mbarëvajtjen e punës.

10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues*

Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në NPB, Gjykatë, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Sektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

11. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme*

- Në muajin janar:

- Është bërë kërkesa në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për dhënie e një përdoruesi (user) të ri, në mënyrë që të mundësohet hapja e një sporteli të ri për eliminimin e radhëve të gjata të qytetarëve para sporteleve në Drejtorinë e Kadastrit. Kjo është miratuar dhe është bërë hapja e sportelit të tretë për shtypjen e certifikatave të pronës.

- Në muajin mars:

- Në Agjencinë Kadastrale dhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është dërguar raporti vlerësues dhe plani i rindërtimit, në mënyrë që të merret vendimi nga ministri për fillimin e procedurës së prokurimit për projektin kapital “Rindërtimi i informacionit kadastral në 2 lagje - distrikte të qytetit të Prishtinës”.

- Në muajin korrik:

- Shpallja e tenderit për projektin kapital “Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në zonën “Qendër” në Prishtinë.

- **Në muajin gusht:**

- Kërkesa në Drejtorinë e Prokurimit për shpalljen e tenderit “Incizimi i hapësirave të përbashkëta banesore” Prishtinë.

- **Në muajin shtator:**

- Vlerësimi i tenderit, projekti “Incizimi i hapësirave të përbashkëta banesore” Prishtinë, me nr. 616 16 122 221.

- **Në muajin tetor:**

- Nënshkrimi i kontratës për projektin “Incizimi i hapësirave të përbashkëta banesore” Prishtinë, me nr. 616 16 122 221.
- Me 20.10.2016, fillimi i punës në terren për projektin “Incizimi i hapësirave të përbashkëta banesore” në Prishtinë, me nr. 616 16 122 221. Vizita nga mbikëqyrësit e projektit ishin Adem Ahmetaj dhe Vjosa Statovci.

- **Në muajin dhjetor:**

- Dorëzimi dhe pranimi i projektit “Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore” në Prishtinë, (me numër të prokurimit: 616 16 122 221). Me anë të këtij projekti është bërë incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në 71 objekte kolektive të banimit dhe është realizuar në lagjet: “Ulpiana” - 18.08 %, “Dardania” - 16.92% dhe në zonën “Qendra” - 4.54 %.